



C.nr.42/09

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ - departamenti i pergjithshem-divizioni civil, me gjyqtarin Enes Mehmeti dhe procesmbajtesen Minrie Krasniqi, ne ceshtjen e inicuar me padine e paditesit [REDACTED] nga [REDACTED] kunder te paditurëve [REDACTED] me pare nga Ferizaj, tani me adese te panjohur te cilen e perfaqeson perfaqesuesi i perkohshem av. [REDACTED] nga [REDACTED] per vertetim pronesia, ne séance e mbajtur me date 31.06.2016, ne pranine e paditesit dhe perfaqesuesit te perkohshem, ne te njejten dite merr kete:

A K T G J Y K I M

- ne baze te pohimit -

APROVOHET kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] nga [REDACTED] dhe **VËRTETOHET** se paditësi është pronar i ngastrave kadastrale 305/8 ne sipërfaqe prej 560 m², 305/9 ne sipërfaqe prej 147 m² si dhe ne pjesen e sipërfaqes prej 92 m² te ngastres aktuale 305/1, e cila me rastin e regjistrimit do te marr numrin e radhes 305/10 ZK Ferizaj, e te cilat gjinden ne rrugen "Astrit Bytyqi" p.n. ne Ferizaj.

OBLIGOHEN e paditura [REDACTED] që paditësi t'ia njohin te drejtën e pronësisë mbi këtë pronë dhe lejojnë regjistrimin e saj ne regjistrat kadastral në emër të paditësit këtë në afat prej 15 ditësh pas pranimit te kopjes së tij, në të kundërtën ky aktgjykim do t'i shërben paditësit ai autorizim për të bërë regjistrimin e pronës në emër të tij.

OBLIGOHET paditësi që të bëjë pagesën e shpenzimeve per perfaqesuesin e perkshem av [REDACTED] për përfaqësim, shumen prej 1,514.00 € si dhe taksën për aktgjykim ne shume prej 50.00€, pas pranimit te ketij Aktgjykimi, nen kercenimin e permbarimit me force.

A r s y e t i m i

Paditesi ka pretenduar me padi se ne vitin 1978 nga e paditura ka blere parcelat objekt kontesti qe shtrihet ne ngastrat kadastrale numer 305/8, 305/9 dhe pjesa prej 92 m² ne parcelen numer 305/1 ZK Ferizaj dhe se ka permbushur ne teresi detyrimet lidhur me pagesen e cmimit dhe ka marr ne posedim te papenguar pronen nga viti 1978 e tutje. Ka kerkuar t'i njihet e drejta e pronesise mbi bazen e mbajtjes me mirebesim dhe te ligjshem.

Gjykata, fillimsht, ka aprovuar propozimin e të autorizuares së paditësit që të paditurit t'i caktohet përfaqesuesi i perkohshem, meqenese e njejta eshte shperngulur jashte Kosoves dhe nuk kane e as qe mund te sigurojne ndonje informacion, per vendndodhjen e saj.

Gjykata aktvendimin per caktimin e perfaqesuesit te perkohshem e ka publikuar ne gazeten zyrtare te Republikes se Kosoves dhe ne tabelen e shpalljeve te kesaj gjykate.

Perfaqesuesi i perkohshem av. [REDACTED] nga [REDACTED] ne seancen e shqyrtimit kryesor, ne fjalen e tij perfundimtare nuk ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit që paditësi të shpallet pronar i pronës kontestuese.

Gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të pohuar duke qenë se në mes palëve ndërgjygjëse nuk ishin kontestuese faktet vendimtare të çështjes dhe se perfaqesuesi i te paditureve shprehimisht ka pranuar kerkespadine dhe në anën tjetër, gjykata nga shqyrtimi i gjithmbarshëm i çështjes nuk ka gjetur ndonjë rrethanë, për të cilën duhet kujdesur kryesisht e e cila do te pengonte aprovimin e kërkesëpadisë dhe rrethana tjera që t'i vënte në kundërshtim faktet dhe provat e çështjes me pohimin e kërkesëpadisë nga ana e përfaqësuesit të perkohshëm të te paditureve, ndaj ne kuptim te nenit 148, ka nxjerr aktgjykim në bazë të pohimit.

Gjykata me qellim te vertetimi te rrethanave lidhur me poziten dhe shtrirjen e prones kontestuese ka bere identifikimin e saj permes ekspertit te gjeodezise me ane te te cilit ka percaktuar paramasat dhe kufizimet e prones objekt kontesti, nga ku ka sqaruar siperfaqen e prones objekt kontesti, pozicionimin e saj- shtrirjen kadastrale ne zone, pronaret juridik te saj dhe shfrytëzuesi aktual te saj dhe per keto te gjetura te ekspertizes gjykata i ka pranuar ne teresi si professionale dhe ne perputhje me gjendjen faktike dhe zyrtare.


Shpenzimet e procedures per perfaqesim te te paditureve nga perfaqesuesi i perkohshem gjykata ia ka ngarkuar paditesi ne kuptim te nenit 81 par.2 lidhur me nenin 453 te LPK-se, ne shumen prej 1,514.00 dhe ate per pergjigje ne padi shumen prej 164.00€ dhe per perfaqesim ne 5 seanca nga 270.00€, ndersa per taksen per aktgjykim ne shume prej 50.00€, ne baze te nenit 445 te LPK-se.

Mbi bazën e parashtrimeve te mesiperme eshte vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr.42/09 date 31.05.2016

Gjyqtari,
Hajr Mehmeti



Keshilla juridike: Kunder ketij aktgjykimi mund te ushtrohet ankese ne afat prej 15 ditesh, pas pranimit te tij, ne gjykatën e Apelit ne Prishtine, permes kesaj gjykate.

REPUBLICA E KOSOVES



VENDIMI ESHTE I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVOSNAZNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROSEVAC

06.07.2016

